

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Në                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| ADRESA  | <a href="https://www.syri.net/politike/915781/video-tomorri-nuk-ka-prodhim-armesh-spak-u-duhet-te-verifikoje-eksportet-te-thirret-ministri-nufi/">https://www.syri.net/politike/915781/video-tomorri-nuk-ka-prodhim-armesh-spak-u-duhet-te-verifikoje-eksportet-te-thirret-ministri-nufi/</a> |
| BURIMI  | syri.net                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                                                        |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 10 shtator 2026, 17:15:55 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 17:05:44 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | c22ef5bd78f46b8ee0eb53ab5866a330776577fe3516e9575d42b96b0c54d093 |
| TEKSTI     | 57b7a49abbe15006aefd012a20678fdc8f953f516c7e9085653944a0a4197df5 |
| PAMJA      | b890645a7468ab9b50052c4e31520d20132ae9328f83ec1176ba8059ef65a3a2 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 3daddf05143c966353797214b5a31956aacb499bcf7a8d0a936b6644a6c06539                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 8df13bbbbd5b9e08ebccccfce3cb93992e5d7a04976148e68633453f6b00d682                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3daddf05143c966353797214b5a31956aacb499bcf7a8d0a936b6644a6c06539>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





**NDRIÇIM KULLA**  
Shoqëria shqiptare, duhet të fillojë betejën me heshtjen e SPAK-ut



**IRENA BEQIRAJ**  
Në Shtetin e Ronit!



## më të lexuarat

Sula: PISA 2025 u shënua me yll, OECD e futi Shqipërinë në 'raportim të kufizuar', qeveria fshehu të vërtetën

Ju përmend emri në bisedën e Ron Yeffet me biznesmenët ukrainas, gazetari Julian Hoxhaj reagon pas audiopërgjimit



## VIDEO/ Tomorri: Nuk ka prodhim armësh, SPAK-u duhet të verifikojë eksportet, të thirret ministri Nufi

19:05, 10/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Gazetari Klodian Tomorri, i ftuar në emisionin 'Task Force' me Sonila Meçon në SYRI TV, ka folur për aktivitetin e kompanisë Advanced Arms Technology dhe deklarimet lidhur me prodhimin dhe eksportin e armëve.

Tomorri deklaroi se, deri më tani, kompania nuk ka prodhuar armë, ndërsa ngriti pikëpyetje mbi planet për ndërtimin e një fabrike armësh në Shqipëri.

Sipas gazetarit, kompanisë pritet t'i jepet një uzinë, në një zonë që ai e identifikoi si Milot ose Rubik, ku do të ndërtohej një fabrikë për prodhimin e armëve.

Tomorri tha se një deklaratë e ministrit të Mbrojtjes, sipas së cilës kompania prodhon armë që janë në përdorim në konflikte, duhet të verifikohet nga institucionet. Sipas tij, nëse një kompani shqiptare nuk ka kapacitet prodhues, por armët vijnë nga vende të tjera dhe më pas marrin dokumentacion shqiptar, kjo do të ngrinte dyshime për një skemë të mundshme të trafikimit ndërkombëtar të armëve.

*'Atëherë, armë nuk ka prodhuar ky. Deri më sot.*

*Këtij do t'i jepet, është ngritur kompania, do t'i jepet uzina e... në mos gabo, o në Milot, o në Rubik, një uzinë atje, ku do të ndërtohet fabrika e armëve. Do të marrë para paradhënie, siç mori me kompaninë tjetër, e cila bën furnizimin e mjeteve. Kompania i ka dy. Njëra është iMAK Defence, e cila merret me makinat, dhe tjetra është Advanced...*

*Nuk ka prodhim armësh.*

*Për ligjet të them, e cila nuk prodhon armë. Se nuk ka fabrikë për prodhim armësh.*

*Po ai mund të deklarojë edhe që erdhën alienët. E ka deklaruar në Parlament ai?*

*Kemi tani atë Advanced Arms Technology, e cila prodhon armë, dhe këto armë, siç e thashë edhe një herë, janë në përdorim sot në konflikte diku. Kjo patentë fiktive...*

SYRI TV/ Ermal Nufi i ikën si 'raketë' pyetjeve të Syri Tv për audiopërgjimin

Noka në 80-vjetorin e Kryengritjes së Postribës: Liria nuk dhurohet, për të duhet luftuar

SYRI TV/ Ngërçi për pagat e gjyqësorit përfundon në dyert e SPAK

SYRI TV/ Debate për audiopërgjimin e Ahmetajt, PD kërkon seanca dëgjimore për aferën

Atëherë, jo. Kjo është një deklaratë për të cilën ky duhet të thirret në SPAK, sepse nuk ka... nuk ka shans që ajo kompani të prodhojë armë. Pikërisht, Advanced Arms Technology duhet të jetë e krijuar, duhet të jetë ngritur si kompani, në mos gabo, në fund të vitit të kaluar... nëntor 2023.

Praktikisht, që ti të ndërtohet një fabrikë për prodhim armësh duhen minimalisht tre vjet. Sepse që të ndërtohet fabrika, do të montohen linjat e prodhimit e të tjera, e të tjera. Nuk ka shanse që Shqipëria të prodhojë armë me këtë kompani.

Atëherë, ai për këtë deklaratë sigurisht duhet të thirret, sepse kjo deklaratë hedh dyshime që këtu mund të bëhet pastaj trafik ndërkombëtar armësh. Pra, mund të merren armë të prodhuara diku tjetër, siç është dyshimi me të cilin bazohet edhe audiopërgjimi, nga Sudani, të cilat legalizohen në Shqipëri...

Thjesht në Shqipëri marrin statusin ligjor sikur janë të prodhuara këtu dhe janë eksport. Pra, kjo është me të vërtetë një deklaratë shumë shqetësuese, sepse nuk ka, matematikisht, praktikisht, teorikisht, si të doni quajeni, nuk ka shanse që Shqipëria...

Po vendet në konflikt, Ukraina është. Pra, po, kanë shkuar atje, kanë shkuar... ose në Izrael.

Dyshimi është Ukraina. Në qoftë se këta kanë bërë këto lloj skemash, që ku di unë...

Duhet të shkojë në Doganë dhe të marrë... Pra, SPAK-u e ka shumë të thjeshtë. Sepse eksporti i armëve nuk bëhet kot. Ka dhe një agjenci shtetërore që licencën kompanitë të cilat kryejnë tregti armësh dhe do të kalosh në doganë, do të marrësh deklaratat doganore, deklaratën e eksportit e kështu me radhë. Pra, këto janë verifikime të thjeshta...', tha gazetari Klodian Tomorri në SYRI TV.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Vila me pishinë si në Santorini e Ballukut, Juristi: SPAK duhej të kishte dorëzuar kërkesën për arrestim në Kuvend



'Audiopërgjimi i Ahmetajt, mesazh për kryeministrin'. Koka: Edhe për SPAK-un që të vihet në lëvizje



Balliu: Kartelet dhe komunizmi, dy rreziqe për një shtet!

Bardhi: Rama hesht për audiopërgjimin ku miku i tij, Ron Yeffet, flet si i zgjedhur nga qeveria për të bërë punët e saj të këqija

Kryengritja e Postribës, Spahia: Ata u ngritën kundër regjimit komunist dhe u bënë shembull për mbarë Shqipërinë

SYRI TV/ Rama reagon pas kallëzimit ndaj Ministrisë së Financave, kërcënon gjyqtarët dhe prokurorët

## TË NGJASHME



VIDEO/ Tomorri: Yeffet nuk i druhet SPAK-ut, por ekspozimit ndërkombëtar, lidhja me Ramën është kapitali i tij



Ambasadori gjerman shuplakë Ramës: Lufta ndaj korrupsionit në nivele të larta parakusht i panegociueshëm për në BE



Ron Yeffet u shqetësua shumë nga Plugu, por aspak SPAK-u!



Takimet e Berishës në Amerikë/ Bardhi: Aleanca me SHBA, një nga vlerat më të mëdha strategjike të Shqipërisë



Blushi: Rama, dhunuesi i grave, po i keqpërdor gratë e PS, që heshtin kur dhunohen gratë e vajzat shqiptare



Konventa Republikane në Teksas/ Berisha takime edhe me senatorë dhe kongresmenë amerikanë



'Shteti ka pushuar së ekzistuari', Muçollari: Paratë e buxhetit transferohen drejtpërdrejt te miqtë...

LAJME POLITIKE KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që iu mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione [info@syri.net](mailto:info@syri.net), për reklama [marketing@syri.net](mailto:marketing@syri.net)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.